

E Mërkura e Madhe - Misteri i Vajimit (Efqelia), për shërim trupi dhe shpirti



Të Mërkurën e Madhe në mbrëmje vijmë në Kishë për të marrë pjesë në Misterin e Vajimit (Efqeli) i cili është një akt i shenjtë. Në këtë Mister ndërsa trupi lyhet me vaj, hiri i Perëndisë thirret të zbresë në personin e sëmurë. Misteri ka për qëllim shërimin e trupit dhe faljen e mëkateve.

Gjatë kësaj Jave të Madhe, ndërsa përgatitemi për Ngjalljen e Krishtit, Kisha na ofron shërim trupor dhe shpirtëror nëpërmjet Misterit të Vajimit.

Ne mendojmë se nuk kemi nevojë për shërim në jetën shpirtërore, sepse nuk kemi bërë ndonjë mëkat të madh; s'kemi vrarë ose vjedhur... etj. Gjithashtu, nëse nuk kemi ndonjë sëmundje të dukshme, nuk mendojmë se jemi të sëmurë trupërisht, por në fakt secili prej nesh është i sëmurë trupërisht edhe shpirtërisht. Si qenie

njerëzore jemi krijuar nga Perëndia për të qenë në një marrëdhënie të përsosur dashurie me Të dhe me të gjithë njerëzit që kemi pranë. Kur bëjmë këtë gjejmë lumturinë e përsosur. Por në vend të kësaj gjejmë zgjidhjen e shkurtër për të qenë të lumtur, kujdesemi vetëm për veten tonë, në vend që të duam Zotin dhe të tjerët. Kështu i shkaktojmë dhimbje dhe sëmundje vetes dhe komunitetit në të cilin jetojmë.

Prandaj, kur vijmë në Kishë të Mërkurën e Madhe në mbrëmje, tregojmë që pranojmë se jemi të sëmurë dhe kemi nevojë për shërimin e Perëndisë.

Misteri i Efqelisë

“A është i sëmurë ndonjë nga ju? Le të thërrasë pleqtë e kishës dhe ata të lutën përmbi të, dhe le ta lyejnë me vaj në emër të Zotit, dhe lutja e besimit do ta shpëtojë të sëmurin dhe Zoti do ta mëkëmbë; dhe nëse ka bërë mëkate, ato do t'i falen” (Jak. 5. 14-15).

Ky Mister themelohet në fjalët dhe veprat e Zotit tonë Jisu Krisht. Përmbledh, shtrin dhe vazhdon shërbimin e Tij shërues. Është shenja e pranisë së Tij, është shfaqja e mbretërisë dhe shenja që bën të dukur shfaqjen që Perëndia e ka ruajtur për botën, kur do të arrijë në gjendjen e përmbushjes finale.

Sëmundja dhe vdekja janë sulmet e pashmangshme, të cilat e kanë prejardhjen nga Rënia. Këto sulme nuk janë tip i hakmarrjes hyjnore, por përfundimi i rënies së thellë të botës nga Perëndia. Lejon vdekjen t'i japë fund jetës e cila shteron nga hiri, jo si dënim, por të ketë mundësi të arrijë plotësimin, në ngjalljen e të vdekurve. Krishti mori sëmundjet tona dhe i veshi ato. Efqelia e Shenjtë është Misteri i besimit. I drejtohet çdo njeriu të sëmurë dhe gjithmonë kryhet me shpresën për shërimin e tij.

Qëllimi bazë i Misterit është që njeriut t'i jepet mundësia të ndajë fitoren e Krishtit dhe të ngjallet në vendin e Mbretërisë së Perëndisë. Trasmeton forcë shpirtërore, që ngacmimet nga sëmundjet të përballohen me forcë, shpresë dhe kurajë.

Misteri nuk zëvendëson mjekimin mjekësor. Në kohë sëmundjeje na udhëheqin fjalët e Shkrimit: “Biri im, sëmundjet mos i lër pas dore, por Zotit t’i lutesh dhe ai do të të shërojë...Veç kësaj thirre mjekun, sepse Perëndia e ka caktuar në këtë shërbim” (Sirah 38. 9-10).

Misteri mund të kryhet në çdo moment për të sëmurin. Kryhet me një seriozitet të veçantë të Mërkurën e Madhe për të gjithë komunitetin, që të shërohen sëmundjet e tyre shpirtërore dhe trupore. Kisha e ofron Efqelinë e shenjtë për të gjithë besimtarët qofshin sëmurë trupërisht ose jo. Kjo shërbesë i kujton besimtarëve fuqinë e Krishtit për të falur dhe për t’i liruar ndërgjegjen nga errësira e mëkatit personal.

Gjatë shërbesës së Misterit lexohen 7 pjesë nga Ungjilli dhe 7 nga Apostulli që na tregojnë për veprën e shërimit që Perëndia do të bëjë për ne.

Një nga këto lexime është nga letra e Jakovit (5:14-15), ku ai udhëzon drejtuesit e Kishës të lyejnë të sëmurët me vaj të shenjtë për shërim. Kur shkojmë të lyhemi me vaj të shenjtë për shërim tregon që ndjekim udhëzimet e Shkrimit të Shenjtë. I kërkojmë Zotit të në shërojë në trup dhe shpirt nga të gjitha sëmundjet e njohura e të panjohura.

Shërimi ynë si person sjell shërim në marrëdhëniet tona me të tjerët në komunitet. Shërimi i secilit kontribuon në shërimin e të gjithëve, sepse jemi të lidhur ngushtë me njeri-tjetrin. Që të kemi një shoqëri dashurie dhe të ecim si bij të dritës, nevojitet t’i kërkojmë Zotit çdo ditë të na shërojë trupërisht dhe shpirtërisht.

Në kishat tona mund të gjeni librin “Uratore e Vogël”, në të cilin gjendet Misteri i Elqelisë.



[Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë](#)